



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Në mbështetje të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale Neni 17. Pika b) dhe o), Si dhe Nenin 40 të Statutit të Komunës së Klinës. Planin Rregullues të Hollësishëm të Komunës së Klinës dhe me kërkesë të datës 29.07.2020 me nr. Prot. 01Nr.351-19006/2020, Kuvendi i Komunës së Klinës në mbledhjen e –VI- të rregullt për vitin 2020 të mbajtur me datë 25.09.2020 mori këtë:

V E N D I M

Për vendosjen e bustit të veprimtarit prof. “Anton Çeta” në qytetin e Klinës

1. Miratohet kërkesa për vendosjen e bustit të veprimtarit prof. “Anton Çeta” në qytetin e Klinës.
2. Vendosja e bustit do të bëhet sipas dakordimit edhe me Forumin e Intelektualeve “Luigj Gurakuqi” Klinë. Si lokacion i mundshëm, por jo i vetëm ofrohet bazamenti në afërsi të Sheshit “Nënë Tereza”
3. Për implementimin e këtij vendimi obligohen kryetari i Komunës, drejtorja e për Urbanizëm, Planifikim Urban dhe Mjedis, drejtorja për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
4. Vendimi është i plotfuqishëm me miratimin në Kuvendin e Komunës, konform Neni 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe 15 ditë pas protokollimit në MPL.

Me këtë vendim njoftohen : MPL, Kryetari i Komunës ,Drejtorja e Urbanizmit, drejtorja për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë , Shërbimi për punë të Kuvendit, Arkivin e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

Nr.01 060-28313 /2020
Datë: 01.10 /2020



Kryesuesi
Fadil GASHI